



EUROPEAN UNION

BALKANMED E-BUSINESS PAGES



*"Ky material komunikimi reflekton vetëm pikëpamjet e autorit dhe Autoriteti Manaxhues i Programit të Bashkëpunimit Ndërrajonal Interreg V-B
Balkan-Mediterranean 2014-2020 nuk është përgjegjës për ndonjë përdorim të informacionit që përmbahet këtu".*



Për Informacione:

Alida Kondi

Qendra për Promovimin e Konkurrueshmërisë

Tel: 00355 692141920

Email: info@ccp.al

<http://www.interreg-balkanmed.eu/approved-project/27/>

<https://www.facebook.com/BalkanMedEBusinessPages/>

<https://www.facebook.com/ccpalbania/>



QENDRA PER PROMOVIMIN E KONKURRUESHMERISE është një organizatë jo-fitimprurëse e krijuar në vitin 2011, me qëllim zhvillimin e kapaciteteve të bizneseve, bizneseve sociale, start-up, institucioneve publike dhe private, organizatave të shoqërisë civile dhe komuniteteve për rritjen dhe forcimin e konkurrueshmërisë, përmes aplikimit të inovacionit, transferimit të teknologjisë, zhvillimit të sipërmarrjes, zhvillimit të kapaciteteve njerëzore dhe institucionale, punësimit, promovimit të turizmit dhe trashëgimisë

kulturore, arsimit dhe formimit profesional për të kontribuar në sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm social edhe ekonomik të vendit.

Prill 2018-Shtator 2020

Projekti **“Mbështetje për Organizatat e Shoqërisë Civile për të zhvilluar Ndermarrje Sociale në Shqipëri”** financuar nga Komisioni Evropian me fonde IPA II po realizohet me sukses nga Qendra. Pas realizimit të një analize të kuadrit ligjor të Ligjit për Ndërmarrjet Sociale, u përgatit një dokument politikash për këtë aspekt.

Një studim mbi situatën e Ndërmarrjeve Sociale në Shqipëri dhe mundësitë që ka Shqipëria për të krijuar Ndërmarrje Sociale u realizua, gjithashtu.

Gjashtë seanca trajnimesh për Organizatat e Shoqërisë Civile që aspironin për të krijuar ndërmarrje sociale u trajnuar për përgatitjen e planit të biznesit d

30 prej Ndërmarrjeve Sociale u mbështetën me grante nga Qendra dhe do të jenë nën mbështetjen e ekspertëve në fazat fillestare nëpërmjet një Programi Coaching



Gusht 2017-Korrik 2019

Projekti **“BalkanMed e-Business Pages”** financuar nga fondet IPA II në kuadër të Programit INTERREG- Balkan Mediterranean Programme 2014-2020, po mbyllet me sukses dhe brenda afateve të përcaktuara që në planifikim duke realizuar të gjitha detyrat e parashikuara në Projekt. Një kontribut i barabartë dhe i ndërsjelltë midis partnerëve bëri të mundur realizimin në kohe dhe me efektivitet të gjithë projektin.



Janar 2016-Janar 2018

Projekti **“Erasmus for Young Entrepreneurs”** financuar nga programi i Konkurrueshmërisë së Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme (COSME) të Komisionit Evropian, u zbatua nga Qendra duke funksionuar si një pikë kontakti në Shqipëri, me funksionin e një organizate ndërmjetëse për të mundësuar dergimin e rreth 15 sipërmarrësve të rinj nga Shqipëria për të marrë trajnim në punë pranë sipërmarrësve me eksperiencë në vendet e BE-së. Sipërmarrësit e rinj fituan eksperiencat e tyre në shtetet si: Irlanda, Hollanda, Spanja, Portugalia, Republika Çeke, Itali, etj.



Shtator 2015-Dhjetor 2016

Projekti **“Enterprise Europe Network –EEN Albania”** financuar nga programi COSME i Komisionit Evropian. Shqipëria u bë pjesë e këtij instrumenti të rëndësishëm të BE-së me të drejta të plota në Shtator 2015.

Qendra realizoi disa aktivitete në kuadër të këtij projekti, si workshop loka, trajnime në Vlorë për fondet e BE-së, si dhe shërbime apo dhënie informacioni për bizneset e interesuara.

Për një numër kompanish u përgatitën profilet e biznesit për mundësi bashkëpunimi me kompanitë e huaja.

PORTOFOLI I PROJEKTEVE VITI 2011-2019

Shtator 2018-Mars 2019

Projekti **“Mbështetje për sipërmarrësit në industrinë kreative”**, të financuar nga **SlovakAid**

2014-2019:

Konsulencë për 5 kompani, me përgatitjen e planeve të biznesit, të bashkëfinancuara nga Programi i Këshillimit të Biznesit të vogël/**BERZH**

Qershor 2017

“Tradita e Vendlindjes Sime” bashkëpunim në organizimin e eventit me shkollën “Misto Mame” Tiranë, financuar nga **Ministria e Kulturës**

Janar 2016-Dhjetor 2016

Projekti **“Formimi dhe pilotimi i funksioneve të njësive për Zhvillimin e vazhdueshëm pedagogjik për mësuesit e shkollave/qendrave të arsimit profesional**, në kuadër të thirrjes për projekte demonstrimi, financuar nga **ETF**

Prill 2015-Gusht 2016

Kontratë shërbimi me Projektin e GIZ i Arsimit Profesional **“Bazat e Didaktikës në Arsimin Profesional”** trajnimi 24-ditor për 25 mësues të Arsimit Profesional, financuar nga **GIZ Albania**

Shtator- Dhjetor 2014:

Kontratë shërbimi me Projektin për Zhvillimin e Burimeve Njerëzore **“Metodat e zhvillimit të kurikulimit për zhvillimin e instruktorëve të Qendrave të Formimit profesional (QFP)”** financuar nga **ILO/Fonde IPA**.

Maj-Korrik 2014:

Trajnim 7-ditor për 45 Instruktorët me programe të akredituara në tematikat: **Bazat e didaktikës në arsimin profesional (2 module)** [Financuar nga **Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA)**.

Tetor-Dhjetor 2013:

Mbështetje individuale, trajnim, coaching dhe ndërtim kapacitesh mbi planifikimin e biznesit për tre fituesit e Konkursit të Dizajnit të Suvenireve, se si t'ju japin vlerë ideve inovative në dizajnim, Projekti “Për Zhvillimin Ekonomik dhe Promovimin e Punësimit” (EDEP), financuar nga **GIZ A Albania**

Shtator- Dhjetor 2013

Projekti **“Arsimi për Biznesin”** angazhoi Qendrën për realizimin e aktiviteteve të lidhura me menaxhimin e burimeve njerëzore në 5 kompani të sektorëve si restoranti, lëndë të para të prodhimit të mobilitetit, shtypshkrime dhe

printime dhe duraluamini, në qytetin e Korçës, financuar nga ky fondacion, që po financohet nga **Fondacioni “TABITA”**.

Janar-Mars 2013

“Mbështetje për qeverinë shqiptare në vetë-vlerësimin e sektorit privat për përgatitjen e programit strategjik të BE-së për Asistencën e re financiare IPA II (2014-2020)”, të financuara nga Projekti- Project Preparation Facility (PPF).

Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA).

Nëntor 2012- Mars 2013

Studim mbi **‘Orientimi në punë i të rinjve që nuk vazhdojnë shkollat e mesme në disa komuna dhe bashki të zonës së Korçës’**, e financuar nga **WORLD VISION- zyra Korçë**

Maj 2013

Përveç kësaj, Qendra ka realizuar mbajtjen e një workshopi në qytetin e Vlorës dhe trajnim në Kurbin, duke bashkëpunuar me zyrat respektive të kësaj organizate.

WORLD VISION- zyra Kurbin

Dhjetor 2012- Janar 2013

Studim **‘Për hartimin dhe rishikimin e 5 kurrikulave për shkollat e mesme profesionale’**, financuar nga **FONDACIONI “TABITA” Korçë**.

Shtator-Dhjetor 2012

Projekti **“Arsimi për Biznesin”**, angazhoi Qendrën për realizimin e aktiviteteve të lidhura me menaxhimin e burimeve njerëzore në 10 kompani të sektorëve si hoteleri, tregti, prodhime mobilerie, duraluamini, në qytetin e Korçës, financuar nga **FONDACIONI “TABITA” Korçë**.

Mars-Shtator 2012

“Edukimi për Sipërmarrjen” Projekt pilot me Universitetin “Aleksandër Xhuvani” Elbasan për edukimin për sipërmarrjen, financuar nga Qendra e Europës Juglindore për Mësimin për Sipërmarrjen (**SEECLE**) në Kroaci.

Janar-Mars 2012

“Trajtime për Komunitetin e Egjiptianëve” në Korçë. Qendra ka ofruar trajnimeve për komunitetin e egjiptianëve dhe për Komitetin e komunitetit të egjiptianëve në qytetin e Korçës. Kjo ka qenë pjesë e projektit të financuar dhe menaxhuar nga **DORCAS AID International (DAI) Albania**.

Dhjetor 2011-Shkurt 2012

“Vlerësimi i impaktit të projektit të shëndetësisë”, Qendra realizoi vlerësimin e projektit për shëndetësinë, të financuar nga Delegacioni i BE-së në Tiranë dhe implementuar nga **Fondacioni “TABITA” Korçë**.

Projekti BalkanMed e-Business Pages është një projekt që po zbatohet në kuadër të Programit të Bashkëpunimit Transnacional, INTERREG VB, si pjesë e Programit Ballkanik-Mesdhetar 2014-2020.

Në objektin e saj projekti parashikohet veprimtari që përputheshin me drejtimin prioritar të Programit: **Sipërmarrja dhe Inovacioni**.

Projekti financohet nga Fondet Evropiane (ERDF dhe IPA II) dhe fondet kombëtare dhe po zbatohet në periudhën dy-vjeçare, duke filluar nga gusht 2017 deri në korrik 2019.

Vendet e që përfshihen në Programin Ballkanik-Mesdhetar janë pesë shtete: Bullgaria, Greqia, Qipro, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria. Secili prej shteteve përfaqësohet në këtë projekt me një organizatë, të cilat në partneritet me njëra-tjetrën krijuan konsorcium, që prej dy-vitesh zbatuan me sukses dhe brenda afateve të përcaktuara projektin e sipërpërmendur.

Aktualisht, NVM-të përfaqësojnë instrumentin më të rëndësishëm për rritjen dhe krijimin e vendeve të punës në shtetet respektive. Prandaj rritja dhe përmirësimi i konkurrueshmërisë së tyre do të përkthehet në përfitime të drejtpërdrejta dhe përfitime afatgjata për komunitetet lokale, veçanërisht për rritjen e punësimit dhe bashkëpunimeve të biznesit, zhvillimin rajonal dhe rritjen e cilësisë së jetës, veçanërisht në vendet përfituese të Projektit.

Pra, në përgjithësi, projekti do të krijonte mundësinë e bashkëpunimit midis subjekteve, bizneseve nga pesë vendet pjesëmarrëse me kushte të ndryshme ekonomike, rregullatore dhe sociale, lehtësimin e transferimit të njohurive dhe teknologjisë, shkëmbimin e praktikave të mira, krijimin e rrjeteve të biznesit dhe proceset e tjera, që kontribuojnë në ndërtimin e kapaciteteve të NVM-ve efikasitetin dhe cilësinë e produkteve dhe shërbimeve të tyre. Buxheti i përgjithshëm i projektit ishte parashikuar deri në **717 588,50 €**.

OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

- ⇒ Qëllimi kryesor i projektit ishte rritja e konkurrueshmërisë së kompanive, veçanërisht ato me orientim eksporti në rajonin e Ballkanit dhe Qipros, përmes zhvillimit të kushteve për zgjerimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal.
- ⇒ Projekti parashikonte krijimin e platformës së internetit BalkanMed E-Business Pages, duke ofruar informacion mbi SME-të e orientuara nga fusha e eksportit, duke promovuar kompanitë dhe duke i bërë veprimtaritë e tyre të dukshme për homologët e tyre të huaj, investitorët potencialë dhe publikun.
- ⇒ Projekti synonte të inkurajonte nismat e bashkëpunimit të biznesit, partneritetet dhe projektet e përbashkëta që rrisin performancën e biznesit dhe që rrisin mundësinë e bashkëpunimit tregtar midis vendeve. Projekti, gjithashtu, synonte të ofronte seminare me informacione me interes për kompanitë për zhvillimin e kapaciteteve të tyre njerëzore.
- ⇒ Gjithashtu, projekti parashikonte edhe krijimin i një seti materialesh informative për të mbështetur rritjen e kapaciteteve dhe konkurrueshmërinë e NVM-ve, duke ofruar informacione mbi analizën e industrive të eksportit në rajonin e Ballkanit, të shoqatave ekzistuese të kompanive dhe grupeve; udhëzues me praktika të mira për transferimin e teknologjisë dhe zhvillimin e klasterave.

Produktet kryesore të këtij Projekti, janë ideuar, zhvilluar dhe zbatuar me sukses nga kontributi i përbashkët i të gjithave organizatave partnere në projekt, ku secila prej tyre ka realizuar detyrat/aktivitetet sikundër ishin parashikuar në projektin e propozuar. Konkretisht janë realizuar:

PERMBLEDHJE E REZULTATEVE

1. Krijimi i platformës së biznesit me adresën www.bmbpages.biz e cila grupon dhe prezanton profilet e rreth 1330 kompanive prej vendeve pjesëmarrëse në program. Platforma mundëson shikueshmërinë dhe ekspozimin e këtyre kompanive ndaj homologëve të tyre në rajon, për të njohur veprimtarinë e njëra-tjetrës, si një mundësi për të inkurajuar bashkëpunimin e biznesit, rritjen e eksportit midis vendeve, investimet etj. Pjesë e platformës janë edhe shoqata të ndryshme, organizata biznesi dhe organizata në formën e klasterave në rajonin e Ballkanit, të cilat luajnë rolin e ndërmjetësit për realizimin e bashkëpunimeve rajonale apo shpërndajnë informacione tek kompanitë e tyre antëtare. Të gjitha kompanitë janë të ndara sipas shteteve Kodit të Aktivitetit NACE dhe mundësi të ndryshme për kërkimin e tyre.

2. Informacione të tjera shtesë dhe praktika të mira në mbështetje të konkurrueshmërisë së NVM-ve nëpërmjet analizave dhe udhëzuesve përbëjnë një pjesë tjetër të rëndësishme të projektit. Konkretisht janë realizuar studime të lidhura me fushat e mëposhtme:

a) Analiza e industrive të eksportit për NVM-të, shoqatat ekzistuese dhe grupimet dhe mundësitë për bashkëpunim;

b) Udhëzues me praktikatat e mira nga kasterat ekzistues dhe shembujt e zbatuar të transferimit të teknologjisë;

c) Udhëzues elektronik për zhvillimin e klasterit;

d) Udhëzues elektronik për transferimin e teknologjisë.

3. Gjithashtu veprimtari për ndërtimin e kapaciteteve dhe veçanërisht për rritjen e bashkëpunimit të drejtpërdrejtë midis kompanive u realizuan brenda ciklit jetësor të projektit. Pesë seminare/takime biznesi me tema të përgjithshme apo specifike u organizohen në pesë vendet pjesëmarrëse. Nga 5 (pesë) përfaqësues nga kompanitë biznesi nga secili vend partner mori pjesë në 5 (pesë) seminare/takime biznesi. Në këto veprimtari u promovua bashkëpunimi ndërmjet kompanive pjesëmarrëse, si dhe informacioneve të tjera të dhëna përmes ligjëratave apo folësve që kontribuan në dobi të kompanive pjesëmarrëse. Rreth 100 kompani përfituan nga ky projekt për të realizuar takime të drejtpërdrejta.





Gjashtë muaj pas fillimit të projektit "BalknaMed Business Pages", organizatat partnere nga Bullgaria, Greqia, Qiproja, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria nisën punën për zhvillimin e një prej rezultateve kryesore të projektit që ishte platforma: www.bmbpages.biz. Platforma do të mundësonte regjistrimin falas të kompanive, shoqatave të biznesit, grupimeve, organizatave mbështetëse të biznesit dhe palëve të tjera të interesuara nga shtetet pjesëmarrëse në Program

dhe do të ofronte mundësi për paraqitjen e profileve të kompanive të ndryshme, produkteve dhe shërbimeve që ato ofronin, si dhe për shprehjen e interesit për bashkëpunim, apo vendosjen e partneriteteve të biznesit.

Kështu pas përfundimit të vitit të parë të projektit platforma ishte ndërtuar dhe ishte në funksionim në versionin beta, pasi ekspertët dhe vetë drejtuesit e projekteve në shtetet e ndryshme bashkëpunuan për të sjellë variantin më të mirë të platformës, si dhe të përfshinin rubrikat më të domosdoshme në këtë funksion.

Përmes platformës elektronike të biznesit, NVM-të nga rajoni jo vetëm promovojnë aktivitetet e tyre, por kanë mundësi edhe të shfaqin apo shprehin fushat e interesit të tyre në bashkëpunime me kompanitë sipas profilit apo vendit respektiv. Tashmë, platforma po shërben si një mekanizëm që lehtëson dhe inkurajon investitorët potencialë në iniciativat e bashkëpunimit të biznesit, partneriteteve dhe projekteve të përbashkëta.

Projekti synonte të jepte kontribut modest në rritjen e shifrave të bilancit tregtar midis vendeve pjesëmarrëse, ku të paktën **1330 profile të NVM-ve në sektorë të ndryshëm** si prodhimi, bujqësia, turizmi, shërbimet e IT-së, sidomos kompanitë me orientim eksporti, janë pjesë e platformës elektronike të biznesit, duke e kapërcyer edhe numrin prej 1200 profilesh të parashikuara në projekt.

Informacioni për bizneset u përmbledh nga hulumtuesit në secilin vend nga zona Ballkanike-Mesdhetare. Platforma e re ofron gjithashtu mundësi për kompanitë e interesuara, që të regjistrohen edhe pas përfundimit të projektit dhe të shprehin interesin e tyre për bashkëpunim me partnerët e tjerë të biznesit në rajonet përkatëse.

Katër mjete analitike në mbështetje të konkurrueshmërisë së biznesit (Tools SME) u zhvilluan brenda kohëzgjatjes së projektit dhe tashmë janë në dispozicion të palëve të interesuara në platformën bmbpages. Këto materiale përfshijnë :

- (1) një analizë të bazës së të dhënave që mbulon industrinë e eksportit me potenciale më të mëdha për zhvillim, produktet kryesore të cilat eksportojnë vendet respektive, marrëdhëniet tregtare të vendeve, bilanci tregëtar i vendet e BE-së dhe marrëdhëniet tregtare midis vetë vendeve në program ;
- (2) një udhëzues me praktika të mira nga zhvillimin e klasterave dhe shembuj të zbatuar të transferimit të teknologjisë;
- (3) (një e-udhëzues për zhvillimin e klasterit dhe
- (4) (një e-udhëzues për transferimin e teknologjisë.

KONFERENCA SHTYPI PER PREZANTIMIN E PROJEKTIT

Projekti BalkanMed e-Business pages në përmbushje të udhëzimeve për promovimin dhe vizibilitetin e projekteve të financuara nga Bashkimit Evropian ka pasur të programuara një serë veprimtarish për të prezantuar arritjet dhe rezultatet kryesore të projektit



Tv Tera Bitola Kompanii od Kipar, Grcija, Albanija i Bugarija zainteresirani za sorabotka so makedon



BULLGARIA

Konferenca e parë për shtyp e Projektit u mbajt më 28 Shtator 2017 në Hotelin Cosmopolit në **Ruse, Bullgari**. Përfaqësuesit e Organizatës udhëheqëse të Projektit, Agjensia e Zhvillimit të Burimeve Njerëzore, prezantuan projektin, qëllimet e tij dhe rezultatet e pritura para gazetarëve dhe mysafirëve pjesëmarrës. Të gjithë përfituesit e projektit patën mundësinë që të shpjegojnë më tej përfitimet dhe rëndësinë e zbatimit të projektit për vendet e tyre dhe t'u përgjigjen pyetjeve të veçanta në lidhje me biznesin dhe zhvillimin e tregtisë ndërkombëtare në rajonin e tyre. Një stacion televiziv kombëtar bullgar dhe pesë media lokale nga Ruse mbuluan ngjarjen dhe publikuan informacione të shkurtra rreth projektit. Zbatimi i projektit do të nxiste interesin e përfaqësuesve të grupit të synuar dhe publikut dhe do të inkurajonte mbështetjen e palëve të interesuara për zbatimin efikas të projektit dhe realizimin e aktiviteteve të parashikuara në projekt.

SHQIPERIA



Pas Bullgarisë, Projekti BalkanMed e-Business Pages u promovua edhe në mediat lokale dhe kombëtare në vendet e tjera pjesëmarrëse. Kështu në 31 Tetor 2017 u mbajt një konferencë shtypi në Hotel "Tafaj" në **Tiranë, Shqipëri**. Përfaqësuesit e Qendrës për Promovimin e Konkurrueshmërisë (CCP), në prezencë të mediave theksuan situatën e bashkëpunimit të biznesit midis pesë vendeve pjesëmarrëse në program dhe rëndësinë e bashkëpunimit ndërrajonal midis bizneseve shqiptare dhe ato të vendeve të tjera prej shteteve pjesëmarrëse në Program.

Në përgjigje të pyetjeve të gazetarëve, përfaqësuesit e CCP përshkruan rezultatet e pritura dhe kontributin e projektit për bashkëpunimin e biznesit midis NVM-ve në zonën e pranueshme dhe shpjeguan se si platforma e parashikuar për tu zhvilluar do të ndryshonte nga një faqe e ngjashme interneti. Konferenca për shtyp u prezantua në mediat televizive ABC News, Fax News dhe media të tjera online si BioNews, etj.



Konferenca e dytë e shtypit u organizua me datën 3 Tetor 2018 në mjediset e Hotel Tirana International. Në përgjigje të pyetjeve të gazetarëve të ftuar, u lançua krijimi i platformës së biznesit **www.bmbpages.biz**. Me këtë rast u shpjegua mbi informacionin që ofronte platforma, si dhe me mundësitë për bashkëpunim midis bizneseve të vendeve të ndryshme.

Gjithashtu u bë thirrje që edhe bizneset e tjera, që nuk ishin akoma pjesë e platformës do të kishin mundësi që të regjistronin vetë profilin e kompanisë së tyre dhe të shprehnin interesin për bashkëpunim me vendet e rajonit, palë në këtë program.

Konferenca e tretë e shtypit u mbajt me datën 19 Mars 2019, në Hotel Tirana International, në ditën kur Qendra për promovimin e Konkurrueshmërisë organizoi Takimin e biznesit B2B me pjesëmarrjen e bizneseve nga vendet pjesëmarrëse në projekt.

MAQEDONIA E VERIUT

Më 20 nëntor 2017, Instituti GAUSS mbajti një konferencë për shtyp në **Manastir të Maqedonisë së Veriut** për promovimin e projektit. Konferenca për shtyp tërhoqi një interes të konsiderueshëm në mesin e gazetarëve të mediave lokale dhe kombëtare. Aktiviteti u transmetua në disa media lokale në zonën e Manastirit.

Dy konferenca të tjera shtypi u mbajtën në Manastir në prezencë të medias që pasqyroi të gjithë veprimtarinë edhe në shtypin lokal.

Intervista u mbajtën me shtypin në ditën e organizimit të takimeve me bizneset e vendeve respektive që morën pjesë në Manastir.



GREQIA

Me 20 dhjetor 2017, Shoqata Helenike e Menaxhimit (HMA) mbajti një Konferencë për shtyp në **Athinë, Greqi** për promovimin e projektit BallkanMed E-Business Pages.

Përfaqësuesit e HMA sqaruan për mediat rëndësinë e këtij projekti për kompanitë Greke dhe bashkëpunimin në rajon. Edhe 2 konferenca të tjera u zhvilluan në përputhje me projektin e planifikuar.

Platforma elektronike, mjetet dhe veprimtaritë e zhvilluara po shërbejnë për nevojat e biznesit dhe komuniteteve lokale në zonat e pranueshme dhe po nxisin rrjetëzimin.



QIPRO

Konferenca e shtypit për Projektin BalkanMed e-Business Pages u mbajt në 18 Janar 2018 në ambientet e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë në Limassol (LCCI), në qytetin e Limassol në Qipro. Presidenti i Bordit të Drejtorëve të Dhomës Z. Costas Galatariotis në përshëndetjen e tij, foli për aktivitetet e përgjithshme të LCCI në fushën e zhvillimit të sipërmarrjes dhe projekteve evropiane.

Përfaqësuesi i Dhomës, Z. Nikolas Iordanou, prezantoi projektin, qëllimet e tij dhe rezultatet e pritshme para gazetarëve dhe të ftuarve të tjerë pjesëmarrës.

Për më tepër, Z. Iordanou parashitroi të gjitha aktivitetet që ishin parashikuar për tu zbatuar, si dhe disa nga produktet kryesore që priteshin të realizoheshin nga ky projekt. Ai promovoi krijimin e platformes së biznesit dhe ftoi kompanitë që të bashkëpunojnë për të dhënë informacionet për kompanitë e tyre për tu bërë pjesë e platformës.

Ashtu si edhe në konferencat e tjera edhe këtu përfaqësuesit e Dhomës së Tregëtisë së Limassolit, dhanë informacione edhe në lidhje me studimet që ishin parashikuar për tu prodhuar dhe për tu ndarë si informacion për bizneset respektive të vendeve pjesëmarrëse.

Konferenca shtypi dhe prezenca në media e projektit është siguruar edhe në periudhën pas realizimit të platformës së biznesit, nëpërmjet të cilave ju behej ftesë edhe bizneseve të parregjistruara që të bëheshin pjesë e platformës.

5 konferenca shtypi në secilin vend u mbajtën edhe në muajt e fundit të projektit për të bërë të njohurit



5 TAKIME BIZNESI NE VENDET PJESËMARRRËSE

B2B

Sipas parashikimeve 5 seminare/takime biznesi të parashikuara për tu zhvilluar në secilin prej shteteve pjesëmarrëse u realizuan me sukses brenda ciklit të parashikuar të projektit. 100 përfaqësues të SME-ve nga vendet partnere të regjistruara në platformën www.bmbpages.biz dhe jo vetëm, patën mundësinë të marrin pjesë në një nga seminarët e projektit. Gjatë këtyre ngjarjeve të mbajtura në secilin vend, NVM-të e përfshira patën mundësinë të realizonin kontakte personale me kompani të tjera homologe, për të diskutuar çështje me interes të përbashkët dhe detaje të bashkëpunimit të mundshëm, si dhe për t'u konsultuar me folësit e shquar, të ftuar në secilin prej takimeve, që përfaqësonin si komisionerë të komisionit evropian, por edhe ekspertë të njohur në fushat përkatëse.



Projekti filloi veprimtarinë lidhur me takimet e biznesit në shtetin grek. Takimi i parë u mbajt nga partneri grek, Shoqata Helenike e Menaxhimit (HMA), nga 26-27 Shkurt 2019 në Athinë në sallën e konferencave të Shoqatës. Në seancën plenare, bazuar në program, ishin ftuar disa folës që mbajtën prezantime me qëllim ngritjen e kapaciteteve të kompanive në drejtim të zhvillimit të inovacionit. Pastaj të gjitha kompanitë e huaja nga 4 shtete të ndryshme Bullgaria, Qipro, Maqedonia e Veriut bënë një prezantim të shkurtër të aktiviteteve të kompanive të tyre, si dhe shprehen interesimin e bashkëpunimit me kompanitë greke dhe pse jo me ato të ardhura nga shtetet e tjera pjesëmarrëse.



Pas pritjes së ngrohtë nga organizata greke, menaxherja e projektit znj. Nina Drageva, nga Bullgaria dha një përmbledhje të projektit për të ndarë dhe shpërndarë rezultatet kryesore të vitit të parë të implementimit të projektit tek pjesëmarrësit.

Seanca e mbasditës vazhdoi me takimet e biznesit midis ndërmarrjeve/kompanive të huaja nga Bullgaria, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, Qipro me ato greke, me kompanitë të, profileve të IT-së, prodhimit dhe distribucionit të produkteve ushqimore. Po ashtu takime të kompanive shqiptare u bënë edhe me shoqatën e prodhuesve të tekstilit të Greqisë, me kompani të fushës së detergjentëve, prodhues të produkteve ushqimore, IT, konsulencë juridike, etj. Takime biznesi u mbajtën gjithashtu midis kompanive nga vende të ndryshme.

Kompanitë: Albpastrim, Roal-Food, Karteri, Albanian Culinary Academy dhe DM Consulting ishin pjesë e delegacionit shqiptar.





Veprimtaria e dytë e konceptuar në formën e takimeve dhe rrjetëzimit të biznesit u mbajt në Tiranë, nga **19-20 Mars 2019, në Hotel Tirana Internacional**. Partneri shqiptar "Qendra për Promovimin e Konkurrueshmërisë" ftoi mbi 100 kompani shqiptare të jenë pjesë e takimeve në Tiranë, duke i vendosur ata në të njëjtën tryezë me 20 kompani të huaja nga 4 vende të ndryshme.

Veprimtaria filloi me një përshëndetje të ngrohtë nga drejtoresha e organizatës partnere në Shqipëri, Znj. Alida Kondi. Ajo i beri të njohur auditorit dhe të ftuarve, një përmbledhje të projektit duke paraqitur rezultatet kryesore të vitit të parë të zbatimit të projektit. U theksua rëndësia e

krijimit të të parës platformë të faqeve të biznesit elektronik që bashkon mbi 1200 kompani të sektorëve të ndryshëm dhe vendeve të ndryshme në të njëjtën platformë.

Projekti në tërësi, dhe veçanërisht platforma, si dhe veprimtaritë me bizneset e organizuara në secilin vend pjesëmarrës, do të kontribuonte në inkurajimin e bashkëpunimit të biznesit midis vendeve dhe do të shërbente për një shkëmbim më të gjerë të ideve dhe informacionit midis pjesëmarrësve. NVM-ve e huaja dhe shqiptare po ju krijohej mundësia për krijimin e kontakteve, marrjen e informacionit për tregjet përkatëse dhe takime që potencialisht mund të rezultojnë në marrëveshje kontraktuale ndërmjet njëri-tjetrit.



Në seancën plenare, z.Bashkim Sykja mbajti prezantimin, si përfaqësues i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Tiranës. Në fjalën e tij, ai foli për marrëdhëniet tregëtare të Shqipërisë me Bashkimin Evropian, rajonin, si dhe potencialet e Shqipërisë për eksport. Ai përmendi mundësinë e produkteve shqiptare për të hyrë në eksport, dhe përmendi disa nga produkteve kryesore që eksportohen nga Shqipëria, si edhe foli për nevojën e zgjerimit të tregjeve, veçanërisht edhe midis vendeve pjesëmarrëse.

Partneri kryesor në marrëdhëniet tregëtare të Shqipërisë nga vendet pjesëmarrëse është Greqia dhe Maqedonia e Veriut. Marrëdhëniet me Qipron ishin në vlera shumë të vogla, ku shpresonim që projekti mund të jepte një kontribut sado të vogël për të nxitur bashkëpunimin.

Ndërsa në prezantimim: "Mundësitë për tërheqjen e investimeve të huaja dhe mjedisi i biznesit në Shqipëri" të mbajtur nga përfaqësuesja e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), znj. Ornella Gjini, kompanitë pritëse u informuan për mundësitë e investimeve në Shqipëria, mbi regjimin tatimor dhe politikat dhe programet e tjera që lehtësojnë investimet e huaja.

Po ashtu, në seancën plenare ju dha mundësia që secila prej kompanive të huaja, të bënte një prezantim të shkurtër të aktivitetit të tyre, si dhe të shprehnin edhe interesin për bashkëpunimin me kompanitë shqiptare, por pse jo edhe me kompanitë e huaja nga 4 vendet e ndryshme Bullgaria, Greqia, Qipro, Maqedonia e Veriut. Profilet kryesore të kompanive të ftuara ishin nga sektorët e bujqësisë dhe mekanikës bujqësore, veçanërisht nga Bullgaria, nga sektorët e prodhimit dhe shpërndarjes së produkteve ushqimeve, makineri për sektorin ushqimor, të produkteve kimikate dhe të pastrimit dhe higjenës, produkte të karburanteve, IT-së, etj.

Pas seancës plenare, në formë të organizuar u realizuan takime midis kompanive të huaja dhe atyre shqiptare, sipas një programi të planifikuar paraprakisht. Në ditën e dytë të këtij eventi pati vizita në kompani. Konkretisht një takim u organizua në mjediset e kompanisë që merret me tregtimin e makinerive që përdoret për kuzhina profesionale dhe supermarkete.

Një prej takimeve të suksesshme u realizua nga kompania shqiptare "Albpastrim" shpk, e cila arriti jo vetëm të krijojë kontakte por edhe bashkëpunim me një prej kompanive greke, që përputhej plotësisht me interesin e vetë kompanisë.





Në hotel Epinal në qytetin e **Manastirit të Maqedonisë së Veriut** u zhvillua nga datat 16-17 Prill 2019 event i parashikuar me pjesëmarrjen e 20 kompanive nga shtetet e tjera respektive në Program. Veprimtaria ishte e organizuar shumë mire. Kompanitë shqiptare paten disa takime me homologët e tyre nga Maqedonia, por edhe me ata të vendeve të tjera. Përfaqësues nga delegacioni shqiptar ishin kompanitë: Fabrika e sallamit "TONA", Agro Besa Invest, AGROTek, Qendistari "Zyberaj" dhe kompani e re "Kikiliciouss".

E gjithë veprimtaria u pasqyrua në mediat lokale të qytetit të Bitolës.

Бизнис- интересите ќе ги уриваат балканските бариери



od Kipar, Grcija, Albanija i Bugarija zainteresirani za sorabotka so makedon




TAKIME BIZNESI NE BITOLA-MAQEDONA E VERIUT

VeprimTaria pasuese u zhvillua në **Sofie-Bullgari**, ndonëse organizata partnere ishte nga qyteti i Ruse. Qëllimi i organizimit të veprimtarisë në Sofje ishte për të siguruar një numër sa më të madh kompanish, të interesuara për të takuar me 20 kompanitë e ftuara. Kështu në datat **10-11 Maj 2019 në Hotel "Vitosha Park"** u organizua takimi i radhës midis kompanive të vendeve të ndryshme. Pas prezantimeve të përfaqësuesve të projektit, veprimtarinë e përshëndeti Znj. Maria Gabriel, anëtare e Parlamentit Evropian dhe komisionere e Komisionit Evropian për çështjet e Ekonomisë dhe Shoqërisë Digjitale.

Veprimtaria vazhdoi me dy sesione paralele sipas fushave të interesit të bizneseve të ftuara për të diskutuar për çështje dhe probleme rajonale me interes për të gjitha palët.. Në pjesën e dytë ditës dhe gjatë ditës së dytë pati takime të drejtpërdrejta midis kompanive, si dhe vizita individuale në kompanitë respektive sipas interesit.

Takime interesante u zhvilluan midis delegacioneve dhe kompanive bullgare. Shqipëria u përfaqësua me kompanitë: Easy Pay, BalkanTrans, Eltec, Apieda dhe BioAlb.



Takimi i fundit midis kompanive u mbaj në qytetin e **Limassolit, në Qipro**. Në hotel “Miramare Atlantica” në datat 25-26 Qershor u mblodhën 20 kompani të huaja. Në seancën plenare Kryetari i Bordit të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Limassol përshëndeti takimin. Prezantime u mbajtën edhe nga përfaqesues të shoqatës së Grave Sipërmarrëse të Ballkanit, e ftuar nga Greqia, si dhe folës të tjerë.

Pas seancës plenare u vazhdua me takime biznesi. Në ditën e dytë disa vizita u realizuan në mjediset e disa kompanive. Nga delegacioni shqiptar merrnin pjesë kompanitë: Dealines, Baer Consulting, Abitat, Eltec dhe Roal Food.



Interreg 
Balkan-Mediterranean
BALKANMED E-BP

BalkanMed
E-Business Pages



Tools for SMEs Competitiveness



www.bmbpages.biz

Developed by

- Human Resources Development Agency - Russe, Bulgaria
- Hellenic Management Association - Athens, Greece
- Limassol Chamber of Commerce and Industry - Limassol, Cyprus
- GAUSS Institute - Foundation for New Technologies, Innovations and Knowledge Transfer - Bitola, North Macedonia
- Centre for Competitiveness Promotion - Tirana, Albania



Gjatë gjithë ciklit të projektit 5 mbledhje me pjesëmarrës nga organizatat partnere u zhvilluan në secilin shtet.

Këto takime ishin frutdhënëse dhe të rëndësishme pasi siguruan që projekti të planifikohet dhe të zbatohet brenda afateve të parashikuara në projekt.

Gjithashtu mbledhjet e projektit shërbyen si një mundësi i mirë networku midis organizatave dhe vetë stafeve të projektit që lehtësoi shumë komunikimin midis njëritjetrit që kontribuoi si për realizimin cilësor të veprimtarive dhe studimeve të planifikuara, por krijoi edhe lidhje të qëndrueshme për të vazhduar partneritetet midis organizatave edhe në projekte të tjera në të ardhmen me fokus ndërrajonal.

Po ashtu edhe veprimtaritë e zhvilluara në kuadër të shkëmbimeve dhe takimeve midis bizneseve, bëri që edhe lidhja midis organizatave partnere të bëhet edhe më e fortë.

PROJEKTI NË MEDIAT SOCIALE

Projekti ka publikuar të gjitha njoftimet dhe ka pasqyruar rigorozisht të gjitha veprimtaritë e saj në faqe të medias sociale <https://www.facebook.com/BalkanMedEBusinessPages>

Faqja është drejtuar nga organizata shqiptare, Qendra për Promovimin e Konkurrueshmërisë, port e gjithë partnerët kanë kontribuar me material.

Po ashtu edhe në faqen zyrtare të Qendrës: <https://www.facebook.com/ccpalbania> të gjitha veprimtaritë e lidhura me projektin janë bërë të njohura në një audiencë më të gjërë.

Po ashtu edhe faqet zyrtare të organizatave të tjera kanë pasqyruar veprimtaritë e zhvilluara në kuadër të projektit.



Për informacione të mëtejshme:

<http://www.interreg-balkanmed.eu/approved-project/27/>

<https://www.facebook.com/BalkanMedEBusinessPages/>



Adresa: HRDA, 14 Kresna Street, Ruse 7000,
Bulgaria
<http://hrda.smebg.net/>
e-mail: hrda@smebg.net:
Tel. +359 82 834 108



hellenic management association

Adresa: Address: 200 Ionias
Ave. & 61 Iakovaton Str.
GR 111 44, Athens, Greece
Tel.: +30 210-2112000
fax: +30 210-2112020-1
e-mail: eede@eede.gr



LIMASSOL CHAMBER
OF COMMERCE AND
INDUSTRY
since 1962

Adresa: 170 Franklin Roose-
velt,
3045 Lemesos, Cyprus
Tel: ++35725855000 ; email:



Adresa: Pitu Guli 27, MK-
7000,
Bitola- Maqedonia e Veriut
Tel: +389 75 222 185;



Adresa Rr."Durrësit" P.7/ shk. 1/Ap. 1,
Tiranë;-ALBANIA
E-mail: info@ccp.al;
Tel +355 692141920;
Web: www.ccp.al,
www.facebook.com/ccpalbania

